



Republika e Kosovës – Republika Kosova  
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia  
Izborni Panel za Žalbe i Predstavke

A.nr. 418/2010

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia (PZAP), në panelin e përbërë nga, Muhamet Rexha kryesues, Ferit Osmani dhe Rafet Haxhaj anëtarë, duke vendosur lidhur me ankesën e subjektit politik Aleanca Kosova e Re (AKR), me seli në Prishtinë, paraqitur kundër Aleancës për Ardhmërinë e Kosovës (AAK), me seli në Prishtinë, për shkak të mbulimit të posterave, në seancën e panelit të mbajtur me 12.12.2010, mori këtë:

## V E N D I M

**MIRATOHET** si e bazuar ankesa e subjektit politik Aleanca Kosova e Re (AKR).

Aleancës për Ardhmërinë e Kosovës (AAK) i shqiptohet dënimi më gjobë në vlerë prej 4050 (katërmijepesëdhjetë) euro, të cilën detyrohet të paguaj në afat prej 15 (pesëmbëdhjetë) dite nga dita e pranimit të këtij vendimi, për tu dërguar pastaj në Buxhetin e Republikës së Kosovës.

## A R S Y E T I M

AKR, ka parashtruar ankesë më të cilën pretendon se subjekti politik AAK, ka bërë shkelje të nenit 33 pika (a) të LZP-së dhe Rregullës Zgjedhore Nr.11/09 neni 3 paragrafi 1 pika (a), *Kodi i Mirësjelljes për Subjektet Politike, Mbështetësit e tyre dhe Kandidatët*.

PZAP ka pranuar një ankesë më datë 10.12.2010, nga AKR, në të cilën theksohet se me 08.12.2010 në ora 23:00 në lagjen e Kurrizit në Tunel në Prishtinë nga subjekti politik AAK, gjegjësisht kandidatja Meliza Haradinaj ka mbuluar me posterat e saj posterat e kandidatit për deputet nga Koalicioni për Kosovën e Re, Behgjet Pacolli, që është në kundërshtim me nenin 33 pika (a) të LZP-së dhe Rregullës Zgjedhore Nr.11/09 neni 3 paragrafi 1 pika (a), *Kodi i Mirësjelljes për Subjektet Politike, Mbështetësit e tyre dhe Kandidatët*.

Parashtruesi i ankesës ka bashkangjitur një fotografi si dëshmi, në të cilën shihet qartë se posterat e kandidatit për deputet në Parlamentin e Republikës së Kosovës, Meliza Haradinaj, nga radhët e subjektit politik AAK, është vendosur mbi posterin kandidatit nga radhët e Koalicionit për Kosovën e Re. Parashtruesi i ankesës propozon që të ndërmerren masat e parapara ligjore.

### **Në kuptim të nenit 4 paragrafi 3 të Rregullave dhe Procedurave të PZAP-it:**

PZAP-i e informoi subjektin politik AAK, më datë 11.12.2010, për ankesën që është bërë ndaj këtij subjekti politik dhe ka kërkuar që të përgjigjet ndaj ankesës deri më datë 12.12.2010, gjerë në ora 12:00.

PZAP-i nuk mori përgjigje në ankesë nga subjekti politik AAK, sipas afatit të caktuar.

### **Veprimet e Ndaluar të Subjekteve Politike**

Dispozita ligjore e Nenit 33 pika (a) i LZP-së dhe neni 3 paragrafi 1 pika (a) e Rregullës Zgjedhore Nr.11/2009, parashohin se:

*Gjatë periudhës së fushatës, subjekti politik, mbështetësit ose kandidatët e tij, ndalohen nga bërja e ndonjërës si në vijim:*

*a) heqja, mbulimi, dëmtimi ose ndryshimi i ndonjë njoftimi, pllakati, posteri ose materiali tjetër i cili përdoret për qëllime të fushatës zgjedhore nga ana e një subjekti tjetër politik;*

### **Përmirësimet dhe sanksionet ndaj shkeljeve**

Neni 120 paragrafi 1 pika (c) i LZP-së, parasheh se:

*Në rast se PZAP-i përcakton se ka ndodhur shkelje e këtij ose rregullave të KQZ-së, mund të:*

*c) të vendos një gjobë ndaj një subjekti politik në vlerë deri pesëdhjetëmijë Euro (€50,000).*

Gjatë përcaktimit të vlerës së gjobës ndaj subjekti politik për ndonjë shkelje, PZAP-i ka marrë parasysh faktorët në vijim:

- Natyra e shkeljes dhe ndikimit të mundshëm të saj në procesin zgjedhor;
- Shkallën dhe peshën e shkeljes;
- Nëse subjekti politik ka marrë pjesë në zgjedhjet e mëparshme, konsiderohet se kanë qenë të njoftuar me obligimet dhe përgjegjësit gjatë procesit të fushatës;
- Nëse subjekti politik ka bërë shkelje të ligjeve zgjedhore në fuqi në këto zgjedhje apo në zgjedhjet e mëparshme në Kosovë;
- Shumën e fondeve të marra nga subjekti politik prej Buxhetit të Republikës së Kosovës, për zhvillimin e aktiviteteve të lidhura më fushatën zgjedhore.

PZAP-i pasi që shqyrtoj dhe analizoi shkresat e lëndës gjeti se;

**- ankesa është e bazuar.**

Nga shkresat e lëndës rrjedh se posterit i kandidates për deputete në Parlamentin e Republikës së Kosovës, Meliza Haradinaj, nga radhët e subjektit politik AAK, është vendosur mbi posterin e kandidatit nga Koalicioni Kosova e Re Behgjet Pacolli.

PZAP-i vlerëson se AAK, shkeljet e kësaj natyre i ka përsëritur në vazhdimësi, andaj konsiderohet si recidivist e cila rrethanë ndikon në lartësinë e dënimit të shqiptuar me gjobë

Prandaj nga këto arsye dhe më qëllim të evitimit të shkeljes së lartcekur po ashtu në pajtim me dispozitat e lart cekura ligjore, PZAP-i vlerëson se ankesa është e bazuar, e lidhur me nenin 115.1 të LZP-së, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

**Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa**

A nr. 418/2010 më datën 12.12.2010

**Kryesuesi i Panelit  
Muhamet Rexha**

